



VENDIM

Nr. 33 Datë 13.05.2014

MBI

**KËRKESËN E NJËRIT PREJ AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
“PROJEKSION ENERGJI” SH.A PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 26, DATË 21.03.2014
“MBI KËRKESËN E NJË PREJ AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
“PROJEKSION ENERGJI” SH.A PËR HEQJEN E LIÇENSËS DHE
ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES MIDIS PALËVE”**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 1 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me Vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e aksionerit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a z. Sokol Riska, për rishikimin e vendimit nr. 26, datë 21.03.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së aksionerit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a, z. Sokol Riska, si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në ndryshimin e vendimit nr. 26, datë 21.03.2014.
2. Lënien në fuqi të vendimit Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 26, datë 21.03.2014, “Mbi kërkesën e një prej aksionerëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a për heqjen e liçensës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve”.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara, për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.